



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government

**UDHËZIM ADMINISTRATIV (QRK) NR. 10/2023 PËR LICENCIMIN E
PROFESIONISTËVE TË HUAJ SHËNDETËSORË¹**

¹ Udhëzimi Administrativ (QRK) NR. 10/2023 për Licencimin e Profesionistëve të Huaj Shëndetësorë, është aprovuar në mbledhjen e 180-të, të Qeverisë së Kosovës, me Vendimin Nr. 15/180, datë 27.12.2023.

Qeveria e Republikës së Kosovës,

Mbështetur në nenin 93 (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 71, paragrafi 3 të Ligjit Nr. 04/1-125 për shëndetësi dhe nenin 8, paragrafi 4, nën-paragrafi 4.5 i Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, si dhe nenin 19, paragrafi 6, nën-paragrafi 6.2 të Rregullores Nr.09/2011 së Punës së Qeverisë,

Nxjerr:

UDHËZIM ADMINISTRATIV (QRK) NR.10/2023 PËR LICENCIMIN E PROFESIONISTËVE TË HUAJ SHËNDETËSORË

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ është rregullimi i procedurës dhe kushteve për marrjen e licencës së profesionistit të huaj shëndetësor për ofrimin e kujdesit shëndetësor.

Neni 2 Fushëveprimi

Ky Udhëzim Administrativ zbatohet për të gjithë profesionistët e huaj shëndetësor dhe të gjitha institucionet shëndetësore të cilat punësojnë këta profesionistë.

Neni 3

1. Shprehjet, termat dhe shkurtesat e përdorura në këtë Udhëzim Administrativ kanë kuptimin si në vijim:

1.1. Ministria–Ministria e Shëndetësisë;

1.2. Ministri – Ministri i Shëndetësisë;;

1.3. MASHTI – Ministria e Arsimit Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit;

1.4. Bordi – trup profesional administrativ për licencim të profesionistëve shëndetësor;

1.5. Licencë – nënkupton lejimin e dhënë përmes vendimit nga Bordi për të ofruar kujdes shëndetësor.

2. Shprehjet, termat dhe shkurtesat tjera të përdorura në këtë Udhëzim Administrativ kanë kuptimin ashtu siç janë të përcaktuara me legjislacionin në fuqi për shëndetësi.

Neni 4

Kushtet për licencim të specialistëve dhe subspecialistëve shëndetësor

1. Institucioni shëndetësor i licencuar nga Ministria i cili dëshiron të angazhojë profesionistë të huaj shëndetësor, parashtron kërkesë për licencim të profesionistit të huaj shëndetësor tek Bordi.

2. Kërkesës për licencim për herë të parë të profesionistit shëndetësor, Institucioni shëndetësor i licencuar nga neni 4 i këtij Udhëzimi i bashkëngjet dokumentet si në vijim:

2.1. Vendimin e nostrifikimit të Diplomës të lëshuar nga MASHTI;

2.2. Certifikatën / Diplomën e specializimit / subspecializimit të lëshuar nga vendi ku është kryer shkollimi;

2.3. Vërtetim për vlefshmërinë e certifikatës së specializimit / subspecializimit nga organi kompetent i vendit ku është kryer shkollimi;

2.4. Plan-programi i specializimit dhe subspecializimit sipas moduleve dhe kohëzgjatjes.

2.5. Planprogramin e detajuar të specializimit dhe subspecializimit nga vendi ku është kryer shkollimi;

2.6. Licencën për kryerje të veprimtarisë shëndetësore të institucionit shëndetësor të fushës përkatëse;

2.7. Licencën e lëshuar nga organi kompetent apo dokument tjetër që vërteton se profesionisti i huaj shëndetësor ka të drejtë të ushtroj profesionin;

2.8. Dëshminë për përvojën profesionale së paku një (1) vit në fushën përkatëse.

3. Të gjitha dokumente sipas paragrafit 2 të këtij neni duhet të jenë kopje të noterizuara dhe të përkthyer në njërën nga gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës nga përkthyesit e licencuar, me përjashtim të dokumentit sipas paragrafit 2.4. të këtij neni.

4. Kërkesës gjithashtu duhet ti bashkëngjiten edhe këto dokumente:

4.1. Kopjen e dokumentit identifikues të profesionistit shëndetësor.

4.2. Lejqëndrimin e vlefshëm apo lejen e punës afatshkurtër në pajtim me ligjin për të huaj në Republikën e Kosovës.

- 4.3. Dëshmi që Institucioni Shëndetësor ka siguruar përkthimin në gjuhën amëtare për pacientin, në të folur në të shkruar dhe formë tjetër eventuale të komunikimit.
- 4.4. Pagesa e taksës administrative në përputhje me Ligjin përkatës për Procedurën e Përgjithshme Administrative.
5. Taksa administrative e paguar për aplikim nuk kthehet pavarësisht nga vendimi i Komisionit.
6. Në rastet kur dokumentacioni nuk është i kompletuar, jepet afat prej 15 (pesëmbëdhjetë ditësh) institucionit shëndetësor për plotësimet e kërkuara.
7. Në rast të mosplotësimit të dokumentacionit sipas kërkesës së Bordit, kërkesa nuk do të trajtohet.
8. Të dhënat mbi licencimin dhe revokimin e licencës së profesionistit të huaj shëndetësor publikohen në faqen zyrtare të Ministrisë.
9. Profesionisti shëndetësorë i huaj i licencuar ka të drejtë të përdor faksimilin (vulën zyrtare) në dokumentet mjekësore.
10. Përdorimi, përmbajtja e faksimilit të profesionistit të huaj shëndetësorë, të licencuar nga Bordi bëhet me vendim të Ministrit në bazë të rekomandimit të Bordit.

Neni 5

Procedura e licencimit të profesionistëve të huaj shëndetësor

1. Për profesionistët e huaj shëndetësor që paraqesin kërkesë për licencim për herë të parë në Republikën e Kosovës, Bordi fillimisht bën barazvlerësimin dhe nostrifikimin e programit specialistik/subspecialistik.
2. Planprogrami i specializimit dhe subspecializimit të profesionistëve shëndetësor të huaj nga vendi ku është kryer shkollimi barazvlerësohet me planprogramin specialistik/subspecialistik të fituar në institucionet përkatëse të Kosovës.
3. Pas barazvlerësimit të planprogramit bëhet nostrifikimi i certifikatës specialistike dhe subspecialistike.
4. Me rastin e barazvlerësimit të planprogramit specialistik/sub-specialistik, Bordi mund të kërkojë edhe dëshmi të tjera, në origjinal ose në përkthim të verifikuar, prej të cilave mund të vlerësohet planprogrami nga vendi ku është kryer shkollimi, kohëzgjatja e tij, dhe dokumente tjera që mund të konsiderohen të nevojshme.

5. Nëse gjatë procedurës së barazvlerësimit konstatohet se planprogrami nga paragrafi 4 nuk përputhet, Bordi kërkon plotësim të planprogramit nëpërmjet praktikës profesionale, modul shtesë apo provim plotësues nga Bordi për shkollim specialistik.

Neni 6

Kushtet për licencim të kuadrit të mesëm, të lartë dhe universitar

1. Kërkesa për licencim për herë të parë të profesionistit të huaj shëndetësor me kualifikim të mesëm të lartë dhe universitar parashtrohet vetëm nga institucioni shëndetësor i licencuar nga Ministria.

2. Kërkesës duhet bashkangjitur:

2.1. Lejeqëndrimin e vlefshëm apo lejen e punës afatshkurtër në pajtim me ligjin për të huaj në Republikën e Kosovës.

2.2. Licencën për kryerje të veprimtarisë shëndetësore të institucionit shëndetësor të fushës përkatëse;

2.3. Vendimin për nostrifikim nga MASHTI.

2.4. Licencën e vlefshme të lëshuar nga organi kompetent apo dokument tjetër që vërteton se profesionisti i huaj shëndetësor ka të drejtë të ushtrij profesionin;

2.5. Dëshminë për përvojën profesionale së paku një (1) vit.

2.6. Dëshminë për pagesën e taksës administrative për licencë.

2.7. Kopjen e dokumentit identifikues;

2.8. Dëshmi që Institucioni Shëndetësor ka siguruar përkthimin në gjuhën amëtare për pacientin, në të folur në të shkruar dhe formë tjetër eventuale të komunikimit.

2.9. Kopjet e origjinalit të të gjitha dokumenteve të kërkuara të përkthyer në njërën nga gjuhët zyrtare nga përkthyesi i autorizuar si dhe të noterizuara;

3. Në rastet kur dokumentacioni nuk është i kompletuar jepet afat prej 15 (pesëmbdhjetë ditësh) institucionit shëndetësor për plotësimet e kërkuara.

4. Në rast të mosplotësimit të dokumentacionit sipas kërkesës së Bordit, kërkesa nuk do të trajtohet.

5. Taksa administrative e paguar për aplikim për licencim nuk kthehet, pavarësisht vendimit të Bordit.

Neni 7

Njohja e kualifikimeve profesionale profesionistëve të huaj shëndetësorë

1. Profesionistët e huaj shëndetësor të përfshirë në marrëveshjet të cilat Republika e Kosovës i ka nënshkruar me vendet tjera për njohje të kualifikimeve profesionale, mund të aplikojnë për njohjen e kualifikimeve profesionale dhe formale të marra në shtetet që janë pjesë e marrëveshjeve.
2. Kërkesa për njohje të kualifikimeve mund të parashtrohet nga institucioni shëndetësor i licencuar nga Ministria, ose nga vetë profesionisti i huaj shëndetësor.
3. Kërkesës i duhet bashkangjitur:
 - 3.1 . Dokumentin e identifikimit të vendit nga vjen profesionisti;
 - 3.2 . Dëshmitë e kualifikimeve formale, të njohura nga MASHTI.
 - 3.3 . Dëshmitë e kualifikimeve profesionale, dhe dëshmia se profesionisti ka qenë i angazhuar në aktivitetin në fjalë dhe dëshmitë tjera siç është përcaktuar në marrëveshje.
 - 3.4 . Lejeqëndrimin e vlefshëm apo lejen e punës afatshkurtër në pajtim me ligjin për të huaj në Republikën e Kosovës.
 - 3.5 . Kopjet e origjinalit të të gjitha dokumenteve të kërkuara të përkthyer në njërin nga gjuhët zyrtare nga përkthyesi i autorizuar dhe të noterizuara;
 - 3.6 Dëshmi që Institucioni Shëndetësor ka siguruar përkthimin në gjuhën amtare për pacientin, në të folur në të shkruar dhe formë tjetër eventuale të komunikimit.

Neni 8

Rastet e veçanta të licencimit

1. Në rastet kur profesionistët e huaj aplikojnë për licencim në programet specialistike dhe subspecialistike të cilat nuk janë të përcaktuara si lëmi specialistike në legjisllacionin përkatës në Republikën e Kosovës, Bordi propozon Komisionin multidisiplinar me profesionistët shëndetësor të lëmive të përafërta, të cilët bëjnë barazvlerësimin dhe nostrifikimin e planprogramit specialistik.
2. Në rast të mungesës së profesionistëve të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, Ministri me vendim mund të angazhojë ekspertë vendorë ose të huaj duke përcaktuar kompenzimin financiar sipas legjisllacionit në fuqi të Republikës së Kosovës.
3. Në raste të jashtëzakonshme dhe emergjente për shëndetin publik që shpallen me vendim të Ministrisë, me vendim të Ministrisë mund të përjashtohet procedurat për licencim të përcaktuara me këtë Udhëzim Administrativ.

Neni 9
Barazvlerësimi dhe nostrifikimi i kualifikimeve të fituara jashtë vendit nga shtetasit e Republikës së Kosovës

1. Profesionistët shëndetësor shtetas të Republikës së Kosovës që kanë kryer shkollimin specialistik dhe sub-specialistik jashtë vendit mund të parashetrojnë kërkesë për barazvlerësim dhe nostrifikim në Bord sipas lëmisë përkatëse.

2. Kërkesës sipas paragrafit 1 të këtij neni, përveç dokumentit identifikues duhet ti bashkëngjiten këto dokumente:
 - 2.1. Vendimin e nostrifikimit të Diplomës të lëshuar nga MASHTI;
 - 2.2. Certifikatën / Diplomën e specializimit /subspecializimit të lëshuar nga vendi ku është kryer shkollimi;
 - 2.3. Vërtetim për vlefshmërinë e certifikatës së specializimit/subspecializimit nga organi kompetent i vendit ku është kryer shkollimi;
 - 2.4. Planprogrami i specializimit dhe subspecializimit sipas moduleve dhe kohëzgjatjes.
 - 2.5. Planprogramin e detajuar të specializimit dhe subspecializimit nga vendi ku është kryer shkollimi;
 - 2.6. pagesën e taksës administrative.

3. Të gjitha dokumente sipas paragrafit 2 të këtij neni duhet të jenë kopje të noterizuara dhe të përkthyer në njërën nga gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës nga përkthyesit e autorizuar, me përjashtim të dokumentit sipas paragrafit 2.5. të këtij neni.

4. Bordi nxjerr vendimin për aprovimin apo refuzimin e kërkesës për nostrifikim dhe barazvlerësim sipas paragrafit 1 të këtij neni.

Neni 10
Bordi për licencim të profesionistëve shëndetësor

1. Bordi është trup profesional administrativ i themeluar nga Ministri me mandat tre (3) vjeçar me mundësi riemërimi edhe për një mandat të dytë tre (3) vjeçar.

2. Bordi përbëhet nga pesë (5) anëtarë:
 - 2.1. Përfaqësues nga Ministria (Kryesues);

 - 2.2. Përfaqësues nga Ministria e Punëve të Brendshme – jurist;

2.3. Përfaqësues nga Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës (profesionist shëndetësor);

2.4 Përfaqësues nga Fakulteti i Mjekësisë (profesionist shëndetësor).

2.5 Një profesionist shëndetësor.

3. Në rast të konfliktit të interesit, anëtari i Bordit nuk merr pjesë në vendimmarrje.

4. Bordi kompensohet sipas ligjit përkatës për paga në sektorin publik dhe akteve nënligjore që derivojnë nga ky ligj.

Neni 11 Detyrat e Bordit

1. Bordi kryen detyrat e mëposhtme:

1.1. Shqyrton kërkesat për licencim dhe rilicencim të profesionistëve të huaj shëndetësor sipas dispozitave të përcaktuara me këtë udhëzim administrativ.

1.2. Kryen procedurat e barazvlerësimit dhe nostrifikimit të planprogramit të specializimit dhe subspecializimit të profesionistëve shëndetësor të Republikës së Kosovës dhe të huaj, të përfunduara jashtë vendit.

1.3. Lëshon, refuzon, vazhdon, ndryshon, pezullon ose revokon licencën e profesionistit të huaj shëndetësor.

1.4. Vepron si trup ekzekutiv që administron dhe mbikëqyrë çështjet lidhur me licencimin e profesionistit të huaj shëndetësor.

1.5. Përpilon raport për Ministrin në afate periodike.

1.6. Kryen detyra tjera të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

2. Bordi nxjerrë rregulloren e brendshme të punës brenda 1 muaji pas emërimit.

Neni 12 Vendimi për licencim

1. Vendimi për licencim të profesionistit shëndetësor merret brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga data e pranimit të kërkesës.

2. Vendimi merret me shumicë votash të anëtarëve dhe nënshkruhet nga kryesuesi i Bordit.
3. Vendimi lëshohet në dy ekstrakte origjinale, nga të cilët një ekstrakt origjinal i dorëzohet palës, ndërsa një ekstrakt mbetet në dosje të lëndës.
4. Një kopje të vendimit nga paragrafi 1 i dërgohet institucioneve përkatëse dhe trupave administrative në Ministri.
5. Licenca lëshohet në kohëzgjatje të njëjtë me kohëzgjatjen e lejes së punës përkatësisht lejes së qëndrimit për profesionistët shëndetësorë. Në rast të lejeqëndrimit të përhershëm, licenca lëshohet me kohëzgjatjen pesë (5) vjeqare.

Neni 13 **Vazhdimi i licencës**

1. Kërkesën për vazhdimin e licencës së profesionistit të huaj shëndetësor e bënë institucioni shëndetësor nga neni 4 i këtij udhëzimi, duke plotësuar kushtet si në vijim:

- 1.1 .Licenca e institucionit shëndetësor;
- 1.2 .Vendimi paraprak për profesionistin shëndetësor të lëshuar nga Bordi;
- 1.3 .Dëshmi për të paktën dhjetë (10) pikë akredituese për një vit;
- 1.4 . Pagesa e taksës administrative;
- 1.5 . Lejeqëndrimin e vlefshëm apo lejen e punës afatshkurtër në pajtim me ligjin për të huaj në Republikën e Kosovës.

2. Kërkesa për vazhdimin e licencës duhet të bëhet brenda afatit prej 30 ditë para datës së skadimit të afatit të vlefshmërisë së vendimit paraprak nga Bordi.

3. Në rast se kërkesa për vazhdim nuk parashtrohet sipas paragrafit 2 të këtij neni, kërkesa do të trajtohet si kërkesë për licencim për herë të parë.

Neni 14 **Thjeshtimi i procedurës dhe kushteve**

1. Me përjashtim dispozitave të nenit 4, 5 dhe 6 të këtij Udhëzimi Administrativ, profesionisti i huaj shëndetësor i cili e ka kryer shkollimin e mesëm, universtar, specialistik dhe sub-specialistik në institucionet e Republikës së Kosovës mund të parashtrrojë kërkesë për licencim në Bord dhe dorëzon dokumentet si në vijim:

1.1 . Diplomën e shkollimit të mesëm, universitar apo certifikatën e shkollimit specialistik / subspecialistik të lëshuar nga institucionet e Republikës së Kosovës.

1.2 . Çertifikatën e dhënies së Provimit për nivelin përkatës.

1.3 . Lejeqëndrimin e vlefshëm apo lejen e punës afatshkurtër në pajtim me ligjin për të huaj në Republikën e Kosovës.

1.4 Dëshminë për pagesën e taksës administrative për licencë.

1.5 Kopjen e dokumentit identifikues;

1.6 Kopjet e origjinalit të të gjitha dokumenteve të noterizuara;

2.Në rastet kur dokumentacioni nga paragrafi 1 nuk është i kompletuar kërkohet nga aplikuesi që brenda afatit prej (15) pesëmbdhjetë ditësh të plotësoj dokumentacionin e kërkuar.

3.Në rast të mosplotësimit të dokumentacionit sipas kërkesës së Bordit, kërkesa nuk do të trajtohet.

4.Taksa administrative e paguar për aplikim për licencim nuk kthehet, pavarësisht vendimit të Bordit.

5.Vazhdimi i licencës së profesionistit shëndetësor të huaj bëhet sipas procedurës dhe kushteve të njëjta sipas nenit 13, më përjashtim licencës së institucionit shëndetësor si dhe të kërkesës, e cila mund të parashtrohet edhe nga vetë profesionisti.

6.Licenca lëshohet në kohëzgjatje të njëjtë me kohëzgjatjen e lejes së punës përkatësisht lejes së qëndrimit për profesionistët shëndetësorë. Në rast të lejeqëndrimit të përhershëm, licenca lëshohet me kohëzgjatjen pesë (5) vjeçare.

Neni 15

Angazhimi i profesionistit shëndetësor pjesëtar i diasporës

1.Profesionisti i huaj shëndetësor pjesëtar i diasporës sipas ligjit përkatës për diasporën, dhe pjesëtarët e komunitetit shqiptar nga vendet fqinje, që kanë kryer fakultetin, shkollimin specialistik dhe subspecialistik jashtë vendit mund të anagazhohen për të ushtruar profesionin në Republikën e Kosovës.

2.Kërkesa për anagazhim të Profesionistit të huaj shëndetësor nga paragrafi 1 bëhet nga institucioni shëndetësor i licencuar nga Ministra, ose nga vetë profesionisti shëndetësor.

3.Kërkesës i duhet bashkangjitur dokumentet e përcaktuara në nenet 4 dhe 6, me përjashtim të lejes së punës apo lejeqëndrimit.

4. Në rast se kërkesa parashtrohet nga vetë profesionisti sipas paragrafit 1 të këtij neni, nuk është e detyrueshme që të bashkëngjitet licenca e institucionit shëndetësorë.

5. Kërkesës i bashkëngjitet edhe certifikata e lindjes dhe/ose certifikatën e lindjes së paraardhësit, për profesionistët shëndetësorë shtetas të huaj që kanë lindur në Kosovë, që e kanë pasur një herë shtetësinë e Kosovës, që ka prejardhje familjare nga Kosova, pjesëtarë të diasporës sipas ligjit përkatës për diasporën.

6. Vazhdimi i licencës së profesionistit shëndetësor të huaj sipas këtij neni bëhet me kërkesë të institucionit të licencuar nga Ministria, apo me kërkesë të profesionistit dhe pa dokumente shtesë nga aplikimi për herë të parë.

7. Kohëzgjatja dhe vazhdimi i licencës lëshohet si në nenin 12 dhe 13 të këtij Udhëzimi.

Neni 16

Angazhimi i profesionistit shëndetësor për qëllime humanitare

1. Profesionisti shëndetësor i huaj mund të angazhohet për qëllime humanitare me ftesë të institucionit shëndetësor publik.

2. Angazhimi nga paragrafi 1 zgjat deri në tridhjetë (30) ditë pune brenda vitit kalendarik.

3. Angazhimi nga paragrafi 1 me tepër se tridhjetë (30) ditë pune brenda vitit kalendarik, lëshohet me autorizim paraprak nga Ministri.

4. Institucioni shëndetësor publik i parashtron kërkesë Bordit së paku pesëmbëdhjetë (15) ditë para angazhimit, duke specifikuar qëllimin e angazhimit, kualifikimet profesionale dhe dokumentin identifikues të profesionistit shëndetësor të huaj.

5. Bordi lëshon vendim për angazhim të profesionistit shëndetësor të huaj për qëllime humanitare sipas këtij neni.

Neni 17

Angazhimi i profesionistit shëndetësor për qëllime edukimi dhe trajnimi

1. Profesionisti shëndetësor i huaj mund të angazhohet për qëllime edukimi dhe trajnimi të profesionistëve shëndetësorë vendor me ftesë të Ministrisë dhe institucioneve të tjera shëndetësore.

2. Të drejtat dhe obligimet dhe çështjet e tjera për angazhimin e profesionistit shëndetësor të huaj nga paragrafi 1 përcaktohet me marrëveshje me institucionin përkatës apo Ministrinë.

3. Institucioni që angazhon profesionistin sipas paragrafit 1 të këtij neni, duhet që pjesë të marrëveshjes të ketë edhe:

3.1. Dëshmi relevante të përkthyer për nivelin akademik, përvojën profesionale specializimin.

3.2. Dëshminë që është i punësuar nga institucioni shëndetësor apo akademik nga shteti ku ushtron profesionin.

Neni 18

Angazhimi i profesionistit shëndetësor për raste të jashtëzakonshme dhe emergjenca në institucionet shëndetësore publike

1. Në rastet e jashtëzakonshme dhe emergjente, me kërkesë të institucionit shëndetësor publik përgjegjës dhe me miratim të Ministrit, profesionistët shëndetësor të huaj lirohen nga procedurat e parashikuara në këtë Udhëzim Administrativ.

2. Ministri me Vendim të veçantë përcakton procedurat dhe kushtet për angazhimin e profesionistëve sipas paragrafit 1 të këtij neni.

Neni 19

Profesionistët e huaj që kanë përfunduar praktikën profesionale në Republikën e Kosovës

1. Kërkesa për licencim të profesionistit të huaj shëndetësor të cilët kanë përfunduar praktikën profesionale në Republikën e Kosovës parashtrohet nga institucioni shëndetësor i licencuar nga Ministria.

2. Kërkesës duhet bashkangjitur:

2.1 . Leje pune apo leje qëndrim nga organi kompetent në pajtim me ligjin për të huaj në Republikën e Kosovës.

2.2 . Licencën për kryerje të veprimtarisë shëndetësore të institucionit shëndetësor të fushës përkatëse;

2.3 . Vendimin për nostrifikim nga MASHTI;

2.4 . Certifikata për dhënien e provimit të licencës;

2.5 . Dëshminë për pagesën e taksës administrative për licencë;

2.6 . Kopjen e dokumentit identifikues;

3. Në rastet kur dokumentacioni nga paragrafi 1, nenparagrafi 1.1 nuk është i kompletuar kërkohet nga aplikuesi që brenda afatit prej (15) pesëmbdhjetë ditësh të plotësoj dokumentacionin e kërkuar.

4. Në rast të mosplotësimit të kërkesës për plotësim të dokumentacionit sipas paragrafit 3 të këtij neni, Bordi nuk trajton kërkesën për licencim të profesionisti shëndetësor i huaj.
5. Taksa administrative e paguar për aplikim për licencim nuk kthehet, pavarësisht vendimit të Bordit.
6. Vendimi për lëshimin e licencës bëhet në pajtim me dispozitat e këtij Udhëzimi.
7. Kërkesa për vazhdimin e licencës së profesionistit të huaj shëndetësor e bënë institucioni sipas nenit 13 të këtij Udhëzimi.

Neni 20 **Përgjegjësia**

Institucioni shëndetësor që angazhon profesionistin shëndetësor të huaj është përgjegjës për dëmin eventual që i shkaktohet pacientit apo individit gjatë ofrimit të kujdesit shëndetësor.

Neni 21 **Sekretaria teknike e Bordit**

1. Për kryerjen e detyrave të përcaktuara në këtë Udhëzim Administrativ, Bordi ndihmohet nga Sekretaria teknike.
2. Sekretaria teknike kryen detyrat e mëposhtme:
 - 2.1. Përgatitë materialin dhe thërret mbledhjen e Bordit.
 - 2.2. Mban procesverbalin dhe evidencën e pjesëmarrjes të mbledhjes së Bordit.
 - 2.3. Siguron dokumentacionin e nevojshëm të punës.
 - 2.4. Dërgon ftesën për mbledhje kryesuesit dhe anëtarëve, me materialin përcjellës së paku tri (3) ditë para mbledhjes.
 - 2.5. Paraqet lëndët e kompletuara sipas datës së aplikimit dhe urgjencave.
 - 2.6. Krijon dhe mban databazë për lëndët që shqyrtohen nga Bordi.
 - 2.7. Mirëmban regjistrin e profesionistëve të huaj shëndetësor që i'u është lëshuar, refuzuar, pezulluar dhe revokuar licenca.
 - 2.8. Përgatitë raporte mujore dhe tre mujore për Bordin.
3. Sekretaria teknike caktohet me vendim të Ministrit.

Neni 22
Komisioni për ankesa

1. Kundër vendimit të Bordit për licencim lejohet ankesa në Komisionin për shqyrtimin e ankesave në Ministrinë e Shëndetësisë.
2. Ankesa duhet të paraqitet brenda tridhjetë (30) ditësh nga data e marrjes së vendimit.
3. Komisioni vendos lidhur me ankesën në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga data e pranimit të ankesës.
4. Ministri me vendim përcakton komisionin për ankesa në këtë përbërje:
 - 4.1. një përfaqësues nga Ministria;
 - 4.2. një jurist;
 - 4.3. një profesionist shëndetësor nga SHSKUK.
5. Puna dhe procedura e komisionit të ankesave bazohet në rregullat e përcaktuara me ligjin për procedurën e përgjithshme administrative dhe dispozitat e këtij udhëzimi administrativ.
6. Kundër vendimit të Komisionit për shqyrtimin e ankesave mund të ushtrohet konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë.

Neni 23
Mbikëqyrja dhe inspektimi

Inspektorati shëndetësor mbikëqyrë institucionin shëndetësor që angazhon profesionistin e huaj të mos tejkaloj afatin e licencës së përkohshme.

Neni 24
Shtojca

Pjesë përbërëse e këtij Udhëzimi është Shtojca I - Taksa administrative për licencimin e profesionistit të huaj shëndetësor.

Neni 25
Dispozitat kalimtare

1. Kërkesa e parashtruar nga pala para hyrjes në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ, do të shqyrtohet në bazë të Udhëzimit Administrativ në fuqi në kohën e parashtrimit të kërkesës.

2. Me përjashtim të paragrafit 1, kërkesa e parashtruar nga pala para hyrjes në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ do të zbatohen dispozitat më të favorshme të përcaktuara me këtë Udhëzim Administrativ.

3. Institucioni publik shëndetësor i cili në momentin e hyrjes në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ, ka pasur të punësuar profesionistë shëndetësor të huaj, mund të parashtojë Bordit kërkesë për vazhdim të licencimit të profesionistit.

4. Kushtet dhe procedura për vazhdimin e licencimit të përcaktuara me këtë Udhëzim Administrativ, zbatohen përshtatshëmrisht edhe për vazhdimin e licencimit sipas paragrafit 2 të këtij neni.

Neni 26 **Dispozitat shfuqizuese**

Me hyrjen në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ shfuqizohet Udhëzimi Administrativ (QRK) Nr.10/2022 për licencimin e profesionistëve shëndetësor të huaj.

Neni 27 **Hyrja në fuqi**

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi në ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

05 janar 2024

Taksa për nostrifikim	150 euro
Taksa për licencim	50 euro
Taksa për rilicencim	50 euro